gura presh : haram màll, hudhra : keq fjalë, presh i zjerë : tobe, hajir ; qepa : jo mirë.

* * *

Në kohën e pemëvet e hyra në bostan : shënon risk, evlat edhe nishan të mirë. Në bostan po të hyjë një mejit : është xhenetshpirt. Himoniku, hajir dhe evlat. Pjepri : s'ka fat të mirë. Kungulli : bereqet, për të sëmurin : shendet. Sallatori, hajir ; pa kohë : jo mirë. Hardhalli del fjalë.

* * *

Gruri : është nimet, po të blesh grurë : shtohet fëmija dhe bereqeti. Kallirijeshill bollëk edhe lirësi, i thati : zi edhe thatësi. Po të shohish kohë lëmi ose në vërdin e lëmit grurë : është mall edhe dituri. Po e korura bimë pa kohë : s'ka prokopi. Elbi hajir, Thekri jo mirë. Mjelli, bazi, kashta : mall edhe lirësi ; e hangura ose e mbledhura bàr : pasuni, e mbjella farë : shënon risk edhe evlat të mbarë.

(Zoti e di më mirë).

Kur sheh nimet, mjaltë, sheqer, oris, pyper, uthull kripë, mish, bulmetra, sherbetra, sapun, ëndra ç' kallëzon ?

Kush sheh nimet : ka risk edhe jetë të mirë Bruma : shënon mall edhe fat E tërhollura brumë shënon risk të gjerë edhe jetë të gjatë. Bruma : për beqarët del martesë e hajir. Po nimet i thatë s'del mirë. Nimet i

nxehtë është risk me dyshim. Nimet i pa pjekur : sëmundje, hidhërim E hangura nimet : risk e hajir. E hangura dhe e pira tepër : s'është mirë. Po i sëmuri po të hajë tepër shërohet Njerzëvet a të vobegtvet po t'ju përndashë hamje : pasunohesh me dituri, fiton naltësi. Gostija shënon mbledhje mbi hajir. Simiti, peksimeti : shënon udhëtim të mirë.

* * *

Mjalti : shënon hallall mall edhe shijë në besë, po e lëpira mjaltë : shënon martesë. Zgjoni i bletës : murad edhe evlad. Sheqeri : gëzim. Po t'ëmblat si bakllava : herë dalin hidhrim. Kadaifi : dituri, Orizi, groshët pasuni. Oriz i zjerë : tregëti Uthulla : shënon bereqet edhe jetë të gjatë. Kripa : paqe edhe mall pa mundim. Puperi : mall me hidhrim.

* * *

Gjella me mish : pasuri. Pastërmaja : udhëtim. Mish i pjekur : hajir. I pa pjekuri : jo mirë. E hangura mishin e njeriut ose e zjera mish në zjar është savitje. Mish'i egërsiravet dhe i shpesërisë : shënon mall. Mish i të mallkuarit : haram mall. E para mish të thatë : është savitje të vdekurit. Dhjam i kafshëvet që ju hahet mishi : është pasuni. Mish i gjahut : tregëti ; po të shohish a po të hash paçe, është malljetimi. Koska e kafshës : del mall edhe veshje.

* * *

Kush sheh bulmet : ka besim edhe bereqet të plotë. Kosi del tobe edhe risk i kollajshëm. Djathi për beqarët :